Asaf Galay është një regjisor i njohur filmash dokumentarë, i cili ka prodhuar shumë filma informues dhe të thelluar për njerëzit që përgjithësisht punojnë në sektorin kulturor. I ardhur nga Izraeli, ai ka marrë përsipër promovimin e kulturës hebraike për pjesën tjetër të botës, përmes prezantimit të artistëve të ndryshëm me famë. Filmografia e tij përfshin *Muzat e këngëtarit Bashevis* (2014), *Ushtria e të dashuruarve të Tokës së Shenjtë* (2018) dhe *Aventurat e Saul Bellow* (2021).



Asaf Galay

Country:
USA

Year of production:
2022

Duration:
01:25:45

Producer:
Naama Pyritz

Director:
Asaf Galay

Writer:
Asaf Galay



THE MIDDLE ROAD / RRUGA E MESIT

SYNOPSIS:

Rosella, an Italian/Albanian artist who lives in Tirana, Albania, reflects on past, present and future in the midst of a frozen era of identity crisis bigger than hers.

BIOGRAPHY


Ardit Muhaxhiri has completed his studies in cinema at the Academy of Film and Multimedia "Marubi". His student film has participated in national and international festivals and won awards. After completing his studies, he tried to work in television as a cameraman and other positions.

PËRMBLEDHJE:

Rosella, një artiste italo-shqiptare që jeton në Tiranë/Shqipëri, reflekton rreth të shkuarës, të tashmes dhe të ardhmes në mes të një epoke të ngrirë dhe të një krize identiteti shumë më të madhe se kriza e saj.

BIOGRAFIA

Ardit Muhaxhiri ka përfunduar studimet për Kinema pranë Akademisë së Filmit dhe Multimedias "Marubi". Filmi i tij studentor ka marrë pjesë në festivale kombëtare dhe ndërkombëtare duke fituar edhe çmime. Pas përfundimit të studimeve ai ka provuar të punojë edhe në televizion si kameraman dhe në pozicione të tjera.



Ardit Muhaxhiri

Country:
Albania

Year of production:
2021

Duration:
11:00

Producer:
IHRFFA

Director:
Ardit Muhaxhiri

Writer:
Ardit Muhaxhiri



THE VOICE OF THAÏS / ZËRI I THAISIT

SYNOPSIS:

Elena Jordi was the first woman to direct a film in Spain. Carla Mingueza, a young actress, goes in the search of "Thaïs" the only film that Elena Jordi made, which is actually considered lost. In that search, Carla will discover who Elena Jordi was and the tragic end of her life and her film.

BIOGRAPHY

David Casals-Roma studied Film and Media at the Birkbeck University of London. He also enrolled in different screenwriting and directing courses in Spain, United Kingdom, France, The Netherlands, Italy and the United States. David has directed short films, documentaries and has written several feature film scripts. He has won over 100 awards worldwide and works as a screenwriting and directing teacher at different film schools in Spain, France and the United States.

PËRMBLEDHJE:

Elena Jordi ishte regjisorja e parë e filmit në Spanjë. Carla Mingueza, një aktore e re, shkon në kërkim të "Thaïs" të vetmit film, të realizuar prej saj, i cili konsiderohet i humbur. Në këtë hulumtim ajo do të zbulojë personalitetin dhe fundin tragjik të jetës dhe filmit të Elena Jordit.

BIOGRAFIA

David Casals-Roma ka studiuar Film dhe Media në Universitetin Birkbeck të Londrës. Ai gjithashtu ka ndjekur kurse të ndryshme të skenarit dhe regjisë në Spanjë, Mbretërinë e Bashkuar, Francë, Holandë, Itali dhe Shtetet e Bashkuara. David ka realizuar filma të shkurtër, dokumentarë dhe ka shkruar disa skenarë filmash artistikë. Ai ka fituar mbi 100 çmime në mbarë botën dhe punon si pedagog skenari dhe regjie në shkolla të ndryshme filmi në Spanjë, Francë dhe Shtetet e Bashkuara.



David Casals Roma

Country:
Spain

Year of production:
2021

Duration:
01:26:37

Producer:
David Casals Roma

Director:
David Casals Roma

Writer:
David Casals Roma



VENICE ELSEWHERE / VENECIA DIKU GJETKË

SYNOPSIS:

A documentary about a city that allows us to talk about imagination, architecture, town planning, art and citizenship. A documentary on identity in a time of uncertainty about borders, when listening to the life stories of people unknown to us can be a clue to understanding. And if not a clue, a valid doubt.

With a question: is it better to photograph a city or to live it?

BIOGRAPHY


Elia Romanelli, graduated in anthropology in Rome and in visual anthropology in Turin. In 2008 he founded the Studio Liz association and is responsible for the direction of: Who creates Venice (2008) and Lën (2011). For DocArt he shoots From Charlie Brown to Valentina and Story of a revolution in pencil strokes (2014). For many years he has collaborated with the University of Ca' Foscari (video communication and with various literature festivals. In London he directs with Piero Vereni the artistic-anthropological project Slices of Life.

PËRMBLEDHJE:

Një dokumentar për një qytet që na lejon të flasim për imagjinatën, arkitekturën, urbanistikën, artin dhe qytetarinë. Një dokumentar për identitetin në një kohë pasigurie për kufijtë, kur rrëfimi i historisë së jetës së njerëzve të panjohur për ne mund të jetë një çelës për të kuptuar dhe nëse jo, një çelës për të ushqyer një dyshim të mbështetur.

BIOGRAFIA

Elia Romanelli, u diplomua për Antropologji në Romë dhe për Antropologji pamore në Torino. Në vitin 2008 ai themeloi shoqatën Studio Liz dhe xhiroi si regjisor filmat: Kush krijoi Venecian (2008) dhe Lën (2011). Për DocArt ai xhiroi Nga Charlie Brown te Valentina dhe Historia e një revolucioni në laps (2014). Për shumë vite ai ka bashkëpunuar me Universitetin e Ca' Foscari (komunikim viziv), me komunitetin hebre dhe me festivale të ndryshme letrare. Në Londër realizoi me Piero Vereni projektin artistiko-anthropologjik Copëza jete.



Elia Romanelli

Country:
Italy

Year of production:
2022

Duration:
01:05:00

Producer:
DocArt

Director:
Elia Romanelli

Writer:
Elia Romanelli

SERENDIPITY



BI & DI
GROUP



KONKURIMI DHE ÇMIMET



KONKURIMI I FILMAVE NË DEA OPEN AIR ZHVILLOHET NË TRI KATEGORI KRYESORE:

1. Filmi me metrazh të gjatë
2. Filmi i shkurtër dhe studentor
3. Filmi dokumentar

dhe ndiqet nga disa juri:

1. Juria e filmit me metrazh të gjatë
2. Juria e filmit me metrazh të shkurtër dhe studentor
3. Juria e filmit dokumentar
4. Juria e medias

KËTO JURI AKORDOJNË DISA ÇMIME DEA, SIPAS EMËRTIMIT TË FESTIVALIT.

JURIA E FILMIT TË GJATË AKORDON ÇMIMET :

1. DEA për Filmin më të mirë:
2. DEA për Regjinë më të mirë në konkurimin e filmit të gjatë:
3. DEA për Skenarin më të mirë në konkurimin e filmit të gjatë
4. DEA për Fotografinë/Kameran më të mirë në konkurimin e filmit të gjatë
5. DEA për Aktorin/Aktoren më të mirë në rol kryesor

JURIA E FILMIT TË SHKURTËR, EKSPERIMENTAL DHE STUDENTOR AKORDON ÇMIMET :

6. DEA për Filmin e Shkurtër më të Mirë
7. DEA për Filmin më të Mirë Studentor

JURIA E FILMIT DOKUMENTAR AKORDON ÇMIMIN :

8. DEA për Filmin më të Mirë Dokumentar

JURIA E MEDIAS AKORDON ÇMIMET :

9. Çmimi i Medias – Filmi i Shkurtër
10. Çmimi i Medias – Filmi i Gjatë

ORGANIZATORËT E DEA OPEN AIR INTERNATIONAL FILMFESTIVAL AKORDOJNË EDHE:

11. DEA e Mirënjohjes (Çmim karriere)
12. DEA Homazh (Çmim përkujtimor)

**BASHKIA TIRANË NDAN ÇMIMIN E PUBLIKU TË TIRANËS
BAZUAR NË VLERËSIMIN E SHIKUESVE TË KRYEQYTETIT.**

COMPETITION AND AWARDS

THE COMPETITION IN DEA OPEN AIR INTERNATIONAL FILM FESTIVAL WILL BE FOLLOWED UP BY SOME JURIES:

1. The feature film jury
2. The short & student film jury
3. The documentary film jury
4. Media jury

THESE JURIES WILL ACCORD SOME DEA AWARDS BASED ON THE FESTIVAL NOMINATION.

THE FEATURE FILM JURY

1. DEA for the best Film (Feature Film Competition)
2. DEA for the best director (Feature Film Competition)
3. DEA for the best script (Feature Film Competition)
4. DEA for the best camera (photography)
(Feature Film Competition)
5. DEA for the best actor/ best actress
(Feature Film Competition)

THE SHORT & STUDENT FILM JURY

6. DEA for the Best Film (Short Film Competition)
7. DEA for the Best Film (Student Film Competition)

THE DOCUMENTARY FILM JURY

8. DEA for the Best Film
(Dokumentary Film Competition)

MEDIA JURY

9. The Media Award (Special Prize)
(Short Film Competition)
10. The Media Award (Special Prize)
(Feature Film Competition)

THE FESTIVAL FOUNDERS ALSO ACCORD:

11. DEA - Gratitude Award
(Lifetime Achievement Award)
12. DEA Homage (Commemorative Award)

THE MUNICIPALITY OF TIRANA ALSO GIVES THE PUBLIC AWARD OF TIRANA BASED ON THE EVALUATION OF THE CAPITAL SPECTATORS.



JURIA E FILMIT ME METRAZH TË GJATË

THE FEATURE FILM JURY



Steffen HACKER

Head of the Jury / Kryetar jurie

Steffen Hacker është regjisor komercial gjerman, pjesë e dyshes regjisoriale “Alex & Steffen” me një sfond të fortë në efektet vizuale. Debutimi i tij si regjisor në “Ingenium” (2018) mori 15 çmime ndërkombëtare. Debutimi i tij ndërkombëtar si bashkëregjisor në

“Bot Wars”, i cili mori dritën jeshile në fillim të vitit 2022, është ende në proces kualifikimi për aktivitete ndërkombëtare.

Steffen Hacker is a German commercial director as part of the directing duo “Alex & Steffen” with a strong background in visual effects. His indie feature directing debut “Ingenium” (2018) received 15 awards internationally. His international co-directing debut “Bot Wars” got greenlit in early 2022 and is being casted at the moment. As part of DEA’s jury, Steffen has an eye for strong technical aspects of films in general and loves to be surprised by all kind of innovative directing ideas, may the be subtle or crazy.



Afrim SPAHIU

Member of the Jury / Anëtar

Spahiu ka studiuar në Akademinë e Teatrit, Filmit dhe Televizionit në Universitetin e Zagrebit. Punoi si kameraman në RTV e Prishtinës (1975 -1976), drejtor fotografie në Kosova-Film (1976-1990), ligjërues i Fotografisë në Departamentin e Dizajnit të Fakultetit të Arteve (1981-1983), dizajner dhe

menaxher shumë projektesh artistike (1983-1990) dhe si pedagog në Gazetari fotografike (2000-2002), Film & fotografi (2002-2005), Fotografi Analogo-digjitalë dhe Fotografi & Film (nga viti 2007) në universitete të ndryshme. Filmografia e tij si drejtor fotografie përfshin rreth 20 tituj filmash nga më të njohurit e kinematografisë shqiptare. Ai ishte gjithashtu anëtar apo drejtues i shumë jurive profesionale në fushën e filmit dhe arteve pamore.

Spahiu was born in Dibra, in the former Yugoslav Republic of Macedonia and studied in the Academy of Theatre, Film and Television at the University of Zagreb. He worked as cameraman in RTV Prishtina (1975 -1976), as director of photography in Kosova-Film (1976-1990), as lecturer of Photography in the Design Department of the Faculty of Arts (1981-1983), as designer and manager of many artistic and commercial projects (1983-1990) and as lecturer of Photojournalism (2000-2002), of Film and Photography (2002-2005), of Analog - Digital Photography and of Movie Photography (from 2007) at various universities. His filmography as director of photography includes about 20 titles of the most famous films of Albanian cinematography. He also was a member or head of many professional juries in the field of film and visual arts.



Andrea STUCOVITZ

Member of the Jury / Anëtar

Stucovitz është producent dhe konsulent i pavarur. Ai filloi të punojë në industrinë audiovizive menjëherë pas studimeve. 1992 u transferua në Toronto (Kanada), ku u punësua në SC Entertainment (sot Cinemavault). Pas kthimit në Itali (1996),

ai punoi për Metro Media, e cila prodhonte katalogët kryesorë të produksioneve filmike dhe televizive të CBS Broadcasting Corporation dhe ishte përgjegjës për dublimin italisht të shumicës së librave të disa kompanive produksioni. Më vonë punoi si menaxher produksioni dhe postproduksioni deri kur themeloi Partner Media Investment (2006), ku aktualisht është pronar dhe drejtor ekzekutiv.

He is an independent producer and consultant. He started to work in the audiovisual industry immediately after his studies. 1992 he moved to Toronto (Canada), where he was employed at SC Entertainment (today Cinemavault). Upon his return to Italy (1996), he worked for Metro Media, which was representing the major film and tv catalogues from CBS Broadcasting Corporation and was in charge of the Italian Dubbing for most of the unsold library of many companies. Later he worked as Production Manager and Post Production Supervisor until 2006, when he established Partner Media Investment, of whom he is currently owner and managing director...



Altin BASHA

Member of the Jury / Anëtar

Altin Basha (regjisor) është pedagog i Mjeshtërisë së Aktorit në Universitetin e Arteve, Tiranë. Është një nga themeluesit e skenës së pavarur teatrore shqiptare. Ka një karrierë të pasur në teatër dhe television

me mbi 40 produksione teatrore, dy seriale TV etj. Themelues i kompanisë së parë teatrore të pavarur OAZ. Regjisor për 17 vjet i kabaretit më të njohur televiziv PORTOKALLI (650 puntata) dhe më pas KOSHERJA (90 puntata), të cilat janë pikë referimi për satirën e fortë politike në Shqipëri. Aktualisht drejton Teatrin Eksperimental Kujtim Spahivogli.

Altin Basha (director) is a lecturer in Acting Art at the University of Arts, Tirana. He is one of the founders of the independent Albanian theater scene. He has a rich career in theater and television with over 40 theatrical productions, two TV series, etc. Founder of the first independent theater company OAZ. He directed for 17 years the most famous television cabaret PORTOKALLI (650 episodes) and then KOSHERJA (90 episodes) which are a reference point for the strong political satire in Albania. He is currently director of the Kujtim Spahivogli Experimental Theater.



Sasho PAVLOVSKI

Member of the Jury / Anëtar

Profesor i asociuar në Universitetin e Filmit ESRA në Shkup dhe pronar i kompanisë Manufaktura Produkcija (Produksion filmash artistikë dhe dokumentarë). Ka lindur në Manastir. Në Sloveni

pati kontaktet e para me artin e kinematografisë. Lufta në ish-Jugosllavi e detyroi të shkojë në Manastir dhe më pas në Bullgari, ku studioi për regji filmi dhe televizioni në Akademinë Krsto Sarafov (BA & MA). Në vitin 1998 ai realizoi filmin e tij të parë televiziv "Emigrantët". Më vonë ai vazhdoi të prodhonte reklama televizive. Ai ka realizuar më shumë se 150 prej tyre dhe disa filma artistikë si regjisor dhe producent

Associate Professor at ESRA Film University Skopje and Company Owner of Manufaktura Produkcija (Films&docs&adds Production). He was born in Bitola. In Slovenia he had his first contacts with the art of cinematography. The war in the former Yugoslavia forced him to go to Bitola and then to Bulgaria, where he studied film and television directing at the Krsto Sarafov Academy (BA & MA). In 1998 he made his first TV movie "Emigrants". He later went on to produce television commercials. He has realised more than 150 of them and several feature films as a director and producer.

JURIA E FILMIT TË SHKURTËR DHE STUDENTOR

THE SHORT AND STUDENT FILM JURY



Esther Maaß

Head of the Jury / Kryetar jurie

Esther Maaß është një aktore gjermane me përvojë në teatër, e cila iu kthye interpretimit të filmave artistikë pas shumë vitesh interpretimi në skenë. Përveç roleve të herëpashershme në seriale gjermane, ajo vijoi me role protagonistësh kryesorë fillimisht në “Genre Movies” dhe më pas në “Ingenium” (2018), rol për të cilin u vlerësua si “Aktorja më e mirë” në katër festivale ndërkombëtare filmi dhe u nominua në shumë syresh. Si pjesë e jurisë së DEA-s, Esther kontribuon me sensin e “leximit midis rreshtave”, gjykimin të narrativës emocionale dhe nivelin e performancës së aktrimit.

Esther Maaß is a classical theatre-trained German actress who turned to feature films after a few years performing on stage. Apart from occasionally appearing on German TV series she appears as main protagonist mostly in “Genre movies”. For her leading role in “Ingenium” (2018) she got awarded as “Best Actress” four times at international film festivals and received numerous nominations. As part of DEA’s jury, Esther has a fine sense of “reading between the lines”, of judging films on an emotional narrative and actor’s performance level.



Adele BUDINA

Member of the Jury / Anëtar

Adele Budina është një producente italo-shqiptare, e cila promovon kulturën shqiptare në Itali përmes binjakëzimit dhe eventeve prestigjioze. Ajo filloi të punojë në fushën e kinemasë në moshën 16 vjeçare duke luajtur një rol në “Letrat drejtuar erës” (2001) dhe në “E diela e

Palmave” (2003). Në vitin 2010 ishte koordinatore e produksionit të filmit artistik “Ballkan Bazar”, bashkëprodhim italo-shqiptar. 2011-2014 punoi në sektorin diplomatik të Ambasadës Shqiptare në Romë. Në vitin 2015 krijoi kompaninë e produksionit A. B. Film në Tiranë, e cila ka prodhuar tre filma të gjatë (2017-2019) dhe tetë dokumentarë televizivë. Në vitet 2017-2019 ajo ka qenë anëtare jurish në disa festivale italiane filmi.

Adele Budina is an Italian-Albanian producer, which promotes Albanian culture in Italy through twinning and prestigious events. She started working in the field of cinema at the age of 16 playing a role in “Letters to the Wind” (2001) and in “Palm Sunday” (2003). In 2010 she was the coordinator of the production of the feature film “Balkan Bazaar”, an Italian-Albanian co-production. 2011-2014 worked in the diplomatic sector of the Albanian Embassy in Rome. In 2015 he created the production company A. B. Film in Tirana, which has produced three feature films (2017-2019) and eight television documentaries. In 2017-2019 she has been a member of juries at several Italian film festivals.



Redi MAZI

Member of the Jury / Anëtar

Redi Mazi është diplomuar për Regji filmi dhe tv në Romë (BA 2005) dhe në UA Tiranë (MA 2013). Ai punon prej 11

vjetësh si regjisor në Sektorin e prodhimit të filmit dokumentar në RTSH. Ai ka realizuar si regjisor dhe skenarist 12 filma dokumentarë, 2 filma të shkurtër, disa videoklipe muzikore, 4 prej të cilëve kanë fituar çmime, emisione, spektakle televizive, etj. Aktualisht punon me dy filma të tjerë dokumentarë.

Redi Mazi was graduated in Film and TV Directing in Rome (BA 2005) and from the University of Arts in Tirana (MA 2013). He has been working for 11 years as a director in the Documentary Film Production Sector at Albanian Radio and Television. He realised as a director and screenwriter 12 documentaries, 2 short films, several music videos, 4 of which have won awards, TV shows and programs, etc. He is currently working on two other documentaries.



DEA OPEN AIR
INTERNATIONAL
FILM FESTIVAL
23-28 June 2022

JURIA E FILMIT DOKUMENTAR

DOCUMENTARY FILM JURY



Ilir KABASHI

Head of the Jury / Kryetar jurie

Ilir Kabashi është diplomuar për regji filmi në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Në vitin 2009 ka përfunduar studimet Master në Regji filmi në Prishtinë. Ai ka shkruar dhe realizuar rreth 20 filma të shkurtër dhe dokumentarë. Disa nga çmimet që ka fituar janë “Best National” në DokuFest, “Juria” dhe “Public Prize” në “One

World”, në Prishtinë, e të tjera. Filmat e tij janë shfaqur në shumë festivale dhe televizione në Kosovë dhe jashtë saj. Temat kryesore të shumicës së filmave të tij dokumentarë, janë të drejtat e njeriut dhe fati i njeriut në shoqëri. Gjatë vitit 2011/2014 ka qenë anëtar i Bordit në Qendrën Kinematografike të Kosovës-QKK. Aktualisht punon në Radio Televizionin e Kosovës-RTK.

Ilir Kabashi graduated in film Directing at the Faculty of Arts in Pristina. In 2009 he finished his Master's degree in Film Directing in Pristina. He has written and directed about 20 short movies and documentary films. Some of the awards that he won are “Best National” in DokuFest, “Jury” and “Public Prize” in “One World”, in Pristina, and others. His films have been shown in many festivals and televisions in Kosova and abroad. In most of his documentary films, the main subject is human rights and the fate of a man in society. During 2011/2014 he had been a member of the Board in the Kosovo Cinematographic Centre-KCC. He currently works in Radio Television of Kosova-RTK.



Vasjan LAMI

Member of the Jury / Anëtar

Aktor, regjisor. Lindur më 21.05.1957 Tiranë. Diplomuar në vitin 1978 në Akademjinë e Arteve, dega e Dramës / Aktor. Në gusht të 1978 fillon punë si aktor në Teatrin

Kombëtar ku vazhdon ende edhe sot. Ka realizuar rreth 60 role në teatër dhe rreth 40 role në film. Në 1994 është Specializuar për Regjisor Teatri në Lille të Francës, pranë Regjisorit Daniel Mesgich.

Actor, director. He was born on May 21, 1957 in Tirana. He graduated in 1978 at the Academy of Arts, for Drama / Actor. In August 1978 he started working as an actor at the National Theater where he continues today. He has performed about 60 roles in theater and around 40 roles in cinema. In 1994 he specialized for Theater Directing in Lille, France, under Director Daniel Mesgich.



Erion KRISTO

Member of the Jury / Anëtar

Lindi në Vlorë në 29 mars 1972. Diplomë, master dhe doktaturë në Filozofi (Estetikë), Romë, Itali. Diplomë dhe master në Gjuhë Letërsi (Kritikë letrare), Universiteti i Tiranës.

Master në Administrim Biznesi, Bordeaux, Francë. Fulbright Scholar në UCLA (Los Angeles, SHBA). Pedagog prej 15 vjetësh në Universitetin Barleti. Gazetar prej 15 vjetësh në emisionin Bardhazi në ABC News. Aktivist i të drejtave civile. Autor librash dhe përkthyes e redaktues. Publicist.

Born in Vlora in 1972. Graduated (MA & PhD) in Philosophy (Aesthetics), in Rome, Italy. Graduated (master's degree) in Literary Language (Literary Criticism), from University of Tirana. Master in Business Administration, Bordeaux, France. Fulbright Scholar at UCLA (Los Angeles, USA). Lecturer for 15 years in Barleti University. Journalist for 15 years of the "Bardh a Zi" Show on ABC News. Civil rights activist. Book author, translator and editor. Publicist.

JURIA E MEDIAS

MEDIA JURY



Elsa DEMO

Head of the Jury / Kryetar jurie

Elsa Demo është e angazhuar për dy dekada me raporte dhe analiza në median e përditshme shqiptare. Për disa vjet ka qenë lektore e Gazetarisë dhe e Arteve në Universitetet e Tiranës dhe Elbasanit. Në bashkëpunim me Ardian

Klosin ka hartuar dy antologji dokumentare dhe letrare, e para për jetën nën diktaturë “Shqipëria kujton 1944-1991” dhe tjetra për epokën post-komuniste “Shqipëria tregon 1991-2010”. Është “doktor i shkencave”. Prej vitit 2018 është autore e emisionit “Artes” në RTSH. Elsa jeton në Tiranë.

Elsa Demo is engaged with reports and analysis on arts and culture in Albanian daily media for two decades. She lectures journalism and Story of Art at University of Tirana and Elbasan. Co-editor with Ardian Klosi of two documentary and literary anthologies, the first about life under dictatorship in Albania: “Shqipëria kujton. 1944-1991” (“Albania remembers. 1944-1991”), and the second about post-communist era “Shqipëria tregon 1991-2010” (“Albania confesses 1991-2010”). She is a PhD for literature studies (Academy of Albanological Studies). She is author of the program “Artes” on RTSH (Albanian Public Broadcaster), since 2018. Elsa lives in Tirana.



Leontina NIKA

Member of the Jury / Anëtar

Leontina Nika ka lindur në Shkodër. Ka studjuar Gjuhë – Letërsi në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër (2002) dhe është specializuar për gazetari televizive në “Network Italia” 2004.

Prej 20 vitesh punon si gazetare kulture në televizionin Top Channel, në gazetatat “Ekspres”, “Gazeta e Tiranës” dhe “Network Albania”, për revistën kulturore “Fokus”, si kryeredaktore për revistën kulturore “Spektër”. Prej 11 vitesh punon në televizionin “Abc” si gazetare për kronikat e kulturës, reportazhet dhe specialet.

Leontina Nika was born in Shkodra. She studied Language and Literature at the University “Luigj Gurakuqi”, Shkodra (2002) and specialized in television journalism at “Network Italia” 2004. For 20 years she has been working as a cultural journalist at Top Channel television, in the newspapers “Ekspres”, “Gazeta e” Tirana “and” Network Albania ”, for the cultural magazine“ Fokus ”and as editor-in-chief for the cultural magazine“ Spektër ”. For 11 years she has been working at “Abc” television as a journalist for cultural chronicles, reports and specials.



Kamuran GORANCI

Member of the Jury / Anëtar

Ekspert i politikave kulturore. Studjoi në Akademinë e Arteve në Beograd. Ka drejtuar për një kohë të gjatë Departamentin e Kulturës dhe Divizionin e Arteve SMP-re në MKRS-ë, Prishtinë. Ka punuar si pedagog i Artit Figurativ dhe drejtor i Gjymnazit “Hajdar Dushi” dhe ka themeluar/drejtuar

Galerinë e Arteve “Vizioni i RI 2000 +” në Gjakovë. Që prej vitit 2009 është profesor i angazhuar në Fakultetin e Arteve të Bukura të UP-së në lëndën: Vizatim dhe Pikturë. Ka realizuar disa projekte kulturore-artistike në Kosovë, ka marrë pjesë në një numër të konsiderueshëm ekspozitash, kolonish arti dhe festivale filmi, drame dhe muzike në Kosovë dhe jashtë saj. Ai ka qenë gjithashtu producent i filmave “ANATEMA” (Agim Sopi), “Etjet e Kosovës” (Sunaj Raça) dhe “Tri dritare dhe një varje” (Isa Qosja).

Born in Prizren. He studied Painting at the Academy of Arts in Belgrade. After them he worked as a professor of Figurative Art, director of “Hajdar Dushi” Gymnasium and founded the Art Gallery “Vision of RI 2000 +” in Gjakova. He also headed the Department of Culture and the SMP Arts Division at MCYS, Pristina, at the head of which he is currently. Since 2009 he is a professor for Drawing and Painting at the Faculty of Fine Arts. He has conducted several cultural and artistic projects in Kosovo, has participated in a number of exhibitions, art colonies and film, drama and music festivals in Kosovo and abroad. He has also been the producer of “ANATEMA” (Agim Sopi), “Kosovo Fathers” (Sunaj Raça) and “Three windows and a hanging” (Isa Qosja).

DEA GRATITUDE AWARD 2022



MUHARREM FEJZO


Muharem Fejzo was an albanian sculptor, opera set designer, film make-up artist, painter, make-up artist, actor, screenwriter and director!

He was born in Starje / Kolonjë - Albania on May 24, 1933. His family moved to the areas of Kolonja between Starje and Erseka until their transfer to Tirana after his father, Ali Kolonja (later Fejzo) came from the USA to take part in the Vlora War as a patriot, sent by the "Vatra" society of the Albanians of America.

1954 - graduated from the Lyceum of Arts (O.Paskali - J.Paco) 1954 - worked for the scenographies of the operas "Rusalka", "Ivan Suzanin", "The Sold Bride" and participated in the national exhibition of fine arts. 1958 - Worked as painter-makeup artist at the Film

Studio "Shqipëria e Re" - first opened the makeup department. 1959 - Specialized in makeup plastic at MosFilm (Moscow/ Russia). 1962 -1966 - worked as a makeup teacher at I.L.A. - Tirana. 1966 - Graduated from I.L.A. in Acting (pedagogue: A. Malo, S. Prosi, D. Agolli). 1966 - Graduated from I.L.A. in Directing (pedagogue: K. Spahivogli). 1966 - Personal exhibition of paintings and sculptures 1967 - Director of Kukës Variety 1970 - 1990 Director at the Kinostudio "Shqipëria e Re". He was honored with the Orders "Naim Frashëri" and "Grand Master".

His first roles were in the movies "Storm" (1959) and "Debatik" (1961). He also worked as a makeup artist for the film "Debatik", as assistant director of two films of 1969 "Why does this drum fall" and "Guerrilla Unit" and directed the film "Montatorja" (1970). In the next 20 years, as a director and in some of them a screenwriter, he realized 13 other feature films: "The Captain" (1972), "Operation Fire" (1973), "The Explosion" (1974), "Threads that are cut" (1975), "Cloaks on wires" (1975), "Spring in Gjirokastra" (1978), "The School" (1979), "New Mornings" (1981), "The Treasure" (1981), "A name among people" (1982), "Bitter Spring" (1985), "Rails" (1988) and "The Living Wall" (1990).



DIRECTOR

- 1989 The Living Wall
- 1987 Rails
- 1985 Bitter Spring
- 1983 A name among people
- 1982 The Treasure
- 1980 New Mornings
- 1981 The Scool
- 1978 Spring in Gjirokastra
- 1977 Cloaks on wires
- 1976 Threads that are cut
- 1974 The Explosion
- 1973 Operation Fire
- 1972 The Captain
- 1970 The Fitter

SCREENWRITER

- 1987 Rails
- 1974 The Explosion
- 1973 Operation Fire
-

MAKEUP ARTIST

- 1963 Special task
- 1961 The Discussion
- 1959 The Whirlwind

SECOND UNIT DIRECTOR OR ASSISTANT DIRECTOR

- 1969 Guerrilla Unit
- 1968 Wait (assistant director)



DEA E MIRËNJOHJES 2022




MUHARREM FEJZO

Ai lindi në Starje / Kolonjë - Shqipëri më 24 maj 1933. Familja e tij u vendos fillimisht në zonat e Kolonjës midis Starjes dhe Ersekës, por u kthye në Tiranë, kur babai, Ali Kolonja (më vonë Fejzo) erdhi nga SHBA për të marrë pjesë në Luftën e Vlorës si patriot, i dërguar nga shoqëria "Vatra" e shqiptarëve të Amerikës.

1954 - mbaroi Liceun Artistik (O.Paskali - J.Paco) 1954 - punoi për skenografitë e operave "Rusallka", "Ivan Suzanin", "Nusja e shitur" dhe mori pjesë në Ekspozitën Kombëtare të Arteve të Bukura. 1958 - punoi si piktor-grimier në Kinostudion "Shqipëria e Re", ku hapi për herë të parë Departamentin e grimit. 1959 - u specializua në kozmetikë plastike në MosFilm (Moskë/Rusi).

1962-1966 - punoi si pedagog grimi në I.L.A. - Tiranë. 1966 - u diplomua në I.L.A. në Aktrim (pedagog: A. Malo, S. Prosi, D. Agolli). 1966 - u diplomua në I.L.A. në Regji (pedagog: K. Spahivogli). 1966 - hapi një ekspozitë personale me piktura dhe skulptura. 1967 - Drejtor i Estradës Kukës, 1970 - 1990 ishte Drejtor në Kinostudion "Shqipëria e Re". Është nderuar me Urdhrat "Naim Frashëri" dhe "Mjeshtër i Madh".

Rolet e tij të para ishin në filmat "Stuhia" (1959) dhe "Debatik" (1961). Punoi gjithashtu si grimier për filmin "Debatik", si asistent regjisor për dy filma të vitit 1969 "Pse bie kjo daulle" dhe "Njësi Gueril" dhe realizoi filmin "Montatorja" (1970). Në 20 vitet e mëpasme, realizoi si regjisor dhe në disa prej tyre si skenarist, 13 filma të tjerë artistikë: "Kapedani" (1972), "Operacioni Zjarri" (1973), "Shpërthimi" (1974), "Fijet që priten" (1975), "Gonat në tela" (1975), "Pranverë në Gjirokastër" (1978), "Mësonjëtorja" (1979), "Mëngjese të reja" (1981), "Thesari" (1981), "Një emër midis njerëzve" (1982), "Pranverë e hidhur" (1985), "Binarët" (1988) dhe "Muri i gjallë" (1990).



REGJISOR

- 1989 Muri i gjallë
- 1987 Binarët
- 1985 Pranverë e hidhur
- 1983 Një emër midis njerëzve
- 1982 Thesari
- 1980 Mëngjeze të reja
- 1981 Mësonjëtorja
- 1978 Pranverë në Gjirokastrë
- 1977 Gunat përmbi tela
- 1976 Fijet që priten
- 1974 Shpërthimi
- 1973 Operacioni Zjarri
- 1972 Kapedani
- 1970 Montatorja

SKENARIST

- 1987 Binarët
- 1974 Shpërthimi
- 1973 Operacioni Zjarri

MAKEUP ARTIST

- 1963 Detyrë e posaçme
- 1961 The Discussion
- 1959 Furtuna

REGJISOR I DYTË OSE AS. REGJISOR

- 1969 Njësi i guerril
- 1968 Prita (assistant director)





DEA HOMAZH 2022

RIKARD LJARJA

Rikard Ljarja has been one of the most famous actors of Albanian theater and cinema. He was born on April 1, 1943 in Shkodra. In 1960 he finished high school in his hometown. In 1965 he graduated from the "Aleksandër Moisiu" High School of Acting (later I.L.A.), Tirana.

For eight years, after graduation, he worked as an actor in the theater "Migjeni" in Shkodra. From 1973 to 1996 he worked as an actor, screenwriter and director for many films produced by Kinostudio "Shqipëria e Re". From 1996 to 2002, he was the artistic director of the Albanian Public Television. Since 1973 he has played leading roles in many well-known films, but has also engaged as a director and screenwriter. He passed in 2020.

ACTOR

- Bar Victims (1996)
- White sheets - (1990)
- Weight of time - (1988)
- Memory Circle - (1987)
- On the verge of life - (1985)
- Bitter Spring - (1985)
- Hell '43 - (1980)
- Radio Station - (1979)
- There is life in snow forests - (1978)
- The Illegals - (1976)
- Early Summer - (1975)
- Alleys sought the sun - (1975)
- White Streets - (1974)
- The Explosion - (1974)
- Consciousness - (1972)
- Stars of the Long Nights - (1972)
- When a day dawned - (1971)
- Old Wounds - (1968)
- Victory over Death - (1967)
- Silent Duel - (1967)
- Commissar of Light - (1966)
- Monuments

DIRECTOR

- Weight of time - (1988)
- When the doors of life open - (1986)
- The end of a blood feud - (1983)
- First day of appointment - (1981)
- Sketerre 43 - (1980)
- Radio Station - (1979)
- There is life in snow forests - (1978)

SCREENWRITER

- Weight of time - (1988)
- When the doors of life open - (1986)



DEA HOMAGE 2022

RIKARD LJARJA

Rikard Ljarja ka qenë një prej aktorëve më të njohur të teatrit dhe kinemasë shqiptare. Lindi më 1 prill 1943 në Shkodër. Në vitin 1960 mbaroi maturën në qytetin e lindjes. Në vitin 1965 u diplomua në Shkollën e Lartë të Aktrimit “Aleksandër Moisiu” (më pas I.L.A.), Tiranë.

Për tetë vite, pas diplomimit, punoi si aktor në teatrin “Migjeni” në Shkodër. Prej vitit 1973 deri në vitin 1996 ai ishte aktor, skenarist dhe regjisor i shumë filmave të prodhuar nga Kinostudio “Shqipëria e Re”. Prej 1996 deri 2002, kur doli në pension, ishte drejtor artistik në Televizionin publik Shqiptar. Që prej vitit 1973 ka luajtur role kryesore në shumë filma të njohur, por është angazhuar edhe si regjisor dhe skenarist. U nda nga jeta në vitin 2020.

AKTOR

- Viktimat e Tivarit (1996)
- Fletë të bardha - (1990)
- Pesha e kohës - (1988)
- Rrethi i kujtesës - (1987)
- Në prag të jetës - (1985)
- Pranverë e hidhur - (1985)
- Skëterrë '43 - (1980)
- Radiostacioni - (1979)
- Në pyjet me borë ka jetë - (1978)
- Illegalët - (1976)
- Në fillim të verës - (1975)
- Rrugicat që kërkonin diell - (1975)
- Rrugë të bardha - (1974)
- Shpërthimi - (1974)
- Ndërgjegja - (1972)
- Yjet e netëve të gjata - (1972)
- Kur zbardhi një ditë - (1971)
- Plagë të vjetra - (1968)
- Ngadhnjim mbi vdekjen - (1967)
- Duel i heshtur - (1967)
- Komisari i dritës - (1966)
- Monumenti

REGJISOR

- Pesha e kohës - (1988)
- Kur hapen dyert e jetës - (1986)
- Fundi i një gjakmarrije - (1983)
- Dita e parë e emrimit - (1981)
- Sketerre 43 - (1980)
- Radiostacioni - (1979)
- Në pyjet me borë ka jetë - (1978)

SKENARIST

- Pesha e kohës - (1988)
- Kur hapen dyert e jetës - (1986)



BASHKIA
TIRANË



QENDRA KOMBETARE E KINEMATOGRAFISE
ALBANIAN NATIONAL CENTER OF CINEMATOGRAPHY



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



UNIVERSITETI I ARTEVE



TEATRI
KOMBETAR
EKSPERIMENTAL
KUJTIM SPAHIVOGLI



TIRANA



FILM & TV PRODUCTIONS



INDOOR & OUTDOOR ADVERTISING



ExLibris

gazetë e përjavshme letrare e kulturore



SERENDIPITY

BI & DI
GROUP



RADIO
TELEVISIONI
SHQIPTAR





Drejtore e Programit të Filmit të Gjatë:
Genc Përmeti

Drejtore e Programit të Filmit Dokumentar:
Dr. Mirela Oktrova

Drejtore e Programit të Filmit të Shkurtër:
Ajola Daja

Drejtore e Programit të Filmit Studentor:
Elis Mataj

Creative Designer:
Albert Malltezi

Multimedia Designer:
Eliodor Markja

Faqja e Internetit/ Website:
Ani Tomçini, Andia Tafa

Marrëdhëniet me publikun:
Dr. Mirela Oktrova, Violeta Murati

Drejtore Festivali/Themelues
Festival Director/Founder:

Edmond Topi (regjisor, producent / director, producer)

Drejtore artistike
Artistic Director:

PhD Mirela Oktrova (studjuese, gazetare – researcher, journalist)

KONTAKT / CONTACT

Festival office Grigor Heba str. 12/17
1080 Tirana Albania

Tel/Fax:
00355 42245889

Email:
info@deafilmfest.al
fonositi@gmail.com

For technical support according to
uploading issues,
please contact us at:
techsupport@deafilmfest.al

Konceptoi dhe realizoi katalogun: Dr. Mirela Oktrova
Përpunimi grafik: **IMEDIA** www.imedia.al



DEA OPEN AIR
INTERNATIONAL
FILM **F**ESTIVAL
23-28 June 2022

